

Kur ju dëgjoni se 10.000 fëmijë janë vrarë gjatë luftës civile të Sirisë, ndoshta ju jeni duke menduar se ata vdiqën nga shpërthimet dhe sulmet ajrore - ju do të keni pjesërisht të drejtë. Nëse janë sulmet e avionëve amerikanë në Pakistan, sulmet ajrore izraelite në Gaza, apo bombat e qeverisë siriane mbi Aleppo - ne jemi të mësuar për të dëgjuar se fëmijët janë vrarë, kryesisht aksidentalisht.

Rrallë herë kemi hasur në raste, kur fëmijët kanë qenë fokusi i snajperëve në rrugë. Megjithatë, kjo ka qenë një realitet për më se tri vite në Siri, transmeton Telegrafi.

Grupi i Kërkimeve të Oxfordit ka gjetur se sulmet nga snajperët kanë vrarë rreth 400 fëmijë sirianë nën moshën 17 vjeçare, duke përfshirë periudhën kohore mars 2011 – gusht 2013.

Ekziston një video e cila do t'iu paraqesë këtë realitet të tmerrshëm. Aty shihet një djalë i ri, ndoshta tetë vjeçar, duke tentuar që të shpëtoji nga snajperi duke shkuar drejt një vajze të re.

Në një moment ai bie në tokë pas një goditje në të, por ai prapë çohet dhe vazhdon të lëvizë. Ai kap vajzën për dore dhe ikin drejt ndonjë vendi më të sigurt duke u “ndihmuar” nga “mjegulla e pluhurit” rreth tyre e shkaktuar nga të shtënat e armëve. /Telegrafi/

[youtubeheight="400"width="100%"align="none"]<http://www.youtube.com/watch?v=mgwO6oni-wY>[/youtube]